

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 41592/14

Nikoll Dobrozi

kundër Shqipërisë

(shihni tabelën bashkëngjitur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 3 tetor 2024 si Komitet i përbërë nga:

Peeter Roosma, *kryetar*,

Andreas Zünd,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*,

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëskancelare në detyrë e Seksionit*,

Duke pasur parasysh kërkesën më sipër të depozituar më 2 qershor 2014,

Duke pasur parasysh deklaratën e paraqitur nga Qeveria e paditur me të cilën i kërkon Gjykatës të çregjistrojë kërkesën nga lista e çështjeve,

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

FAKTE DHE PROCEDURA

Detajet e kërkesit jepen në tabelën bashkëngjitur.

Kërkuesi u përfaqësua nga z. M. Pëllumbi, avokat i licencuar në Tiranë.

Ankimet e kërkesit sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës në lidhje me tejkalimin e kohëzgjatjes së procesit civil i janë komunikuar qeverisë shqiptare ("Qeveria").

LEGJISLACIONI

Pas negociimit të pasuksesshëm për zgjidhje miqësore, Qeveria informoi Gjykatën që ajo propozonte të bënte një deklaratë të njëanshme, me qëllim zgjidhjen e problemeve të ngritura në këtë ankim. Më tej, ajo i kërkoj Gjykatës të çregjistrojë kërkesën në përputhje me nenin 37 të Konventës.

Qeveria pranoi tejkalimin e kohëzgjatjes së procesit civil. Ajo u ofrua që t'i paguajë kërkesit shumat e detajuara në tabelën bashkëngjitur dhe ftoi Gjykatën të çregjistrojë kërkesën nga lista e çështjeve, në përputhje me nenin 37 § 1 (c) të Konventës. Shumat e mësipërme duhet të konvertohen në monedhën e Shtetit të paditur me kursin e këmbimit të datës së pagesës dhe duhet të paguhën brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës. Në rast të mospagimit të këtyre shumave brenda periudhës tremujore të lartpërmendur, Qeveria merr përsipër të paguajë një kamatëvonesë të thjeshtë nga mbarimi i kësaj periudhe deri në momentin e shlyerjes, me një normë të barabartë me normën e marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pike përqindjeje.

Pagesa do të përbëjë zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Kërkuesi nuk u përgjigj.

Gjykata vëren që neni 37§1(c) mundëson çregjistrimin e një çështjeje nga lista e saj:

"... për çdo arsye tjetër që, sipas Gjykatës, nuk justifikon vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës".

Prandaj, ajo mund të çregjistrojë kërkesën sipas nenit 37§1(c) bazuar në një deklaratë të njëanshme nga një Qeveri e paditur edhe nëse kërkesit dëshirojnë vazhdimin e shqyrtimit të çështjes (shihni në veçanti, *Çështja Tahsin Acar kundër Turqisë* vendimi (kundërshtime paraprake) [DHM], nr. 26307/95, §§75-77, GJEDNJ 2003-VI).

Gjykata ka krijuar praktikë gjyqësore të qartë dhe të gjerë në lidhje me ankimet për tejkalimin e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore (shihni për shembull, *Luli dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 64480/09 dhe 5 të tjera, 1 prill 2014 dhe *Mishgjoni kundër Shqipërisë*, nr. 18381/05, 7 dhjetor 2010).

Duke pasur parasysh pranimet që përmban deklaratat e Qeverisë, si edhe shumën e propozuar për kompensim – që është në përputhje me shumën e caktuar në çështje të ngjashme – Gjykata vlerëson që nuk justifikohet më tej vazhdimi i shqyrtimit të kërkesës (neni 37§1(c)).

Nisur nga vlerësimet e mësipërme, Gjykata është e bindur që respektimi i të drejtave të njeriut, siç përcaktohet në Konventë dhe Protokollin e saj, nuk kërkon që ajo të vazhdojë të shqyrtojë kërkesën (neni 37§1 *in fine*).

Në përfundim, Gjykata thekson që, nëse Qeveria nuk përmbush kushtet e deklaratës së saj të njëanshme, kërkesa mund të futet përsëri në listë në përputhje me paragrafin 2 të nenit 37 të Konventës (shihni *Josipović kundër Serbisë* (vendim), nr. 18369/07, 4 mars 2008).

Nisur nga sa më sipër, është me vend që çështja të çregjistrohet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht:

Mban parasysh kushtet e deklaratave të Qeverisë së paditur dhe të rregullimeve për të siguruar përmbushjen e angazhimeve të përmendura në to;

Vendos të çregjistrojë kërkesën nga lista e saj e çështjeve në përputhje me nenin 37§1(c) të Konventës.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 24 tetor 2024.

Viktoriya Maradudina
ZËVENDËSKANCELARE NË DETYRË

Peeter Roosma
KRYETAR

SHTOJCË
KËRKESA QË PARAQET ANKIMIN SIPAS NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS
(Tejkalimi i kohëzgjatjes së procesit civil)

Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkuarit Viti i lindjes	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Data e marrjes së deklaratës së Qeverisë	Shuma e dhënë për dëmin jopasuror (në euro) ¹	Shuma e dhënë për kosto dhe shpenzime (në euro) ²
41592/14 2.6.2014	Nikoll DOBROZI 1961	Mark Pëllumbi Tiranë	24.5.2024	1.200	250

¹ Plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuarit.

² Plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuarit.